



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---


Nr. 01/41

Datë: 10.10.2011

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 tetor 2011, mori:

**V E N D I M**

1. Miratohen Projekt-kodi Penal i Republikës së Kosovës.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Projekt-kodin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

  
Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 02/41  
Datë:10.10.2011

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 tetor 2011, mori:

**V E N D I M**

1. Themelohet komisioni ndërministror që ti udhëheq përgatitjet për projektin për zhvillimin e Brezovicës dhe për ti zbatuar procedurat, me qëllim që të zhvillohet projekti i bazuar në investime private.
2. Komisioni përbëhet nga:
  - 2.1 Mimoza Kusari-Lila, Zëvendëskryeministre dhe ministre e Tregtisë dhe industrisë - Kryesuese
  - 2.2 Slobodan Petroviq, Zëvendëskryeministër dhe ministër i administrimit të pushtetit lokal - anëtar
  - 2.3 Bedri Hamza, Ministër i Financave - anëtar
  - 2.4 Vlora Çitaku, Ministre e Integritimit Evropian - anëtare
  - 2.5 Dardan Gashi, Ministër i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor - anëtar
  - 2.6 Bratislav Nikolic, Kryetar i Komunës së Shtërpçës - anëtar.
3. Në përputhje me proceset e Partneritetit Publiko-Privat, Komisioni ndërministror do të marrë vendime lidhur me aprovimin e projektit të Brezovicës dhe çdo vendim tjetër me shumicë votash, duke përfshirë votën afirmative të Ministrit të Financave dhe Kryetarit të Komunës së Shtërpçës.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Komunës së Shtërpcës
- Arkivit të Qeverisë